

PROCESVERBAL

I mbajtur me rastin e mbledhjes së 1 (parë) të rregullt për vitin 2026,të Kuvendit të Komunës së Suharekës

Vendi:	Suharekë
Zyra:	Salla e Kuvendit të Komunës
Data:	14.01.2026
Ora:	10:00

Prezentë në takim:

Znj. Sanie Kuçi
Rexhepaj

Z. Flamur Bytyçi

Znj. Doruntina Zenelaj

Z. Urim Suka

Z. Astrit Salihu

Z. Nexhat Ramadani

Znj. Vlorë Kryeziu

Znj. Dafina Kolgeci

Z. Bexhet Kuçi

Z. Visar Kuçi

Z. Mensur Selimaj

Z. Edon Sadikaj

Z. Aziz Bytyçi

Znj. Mimoza Bajraktari

Z. Enver Shabani

Znj. Albulena Kokollari

Znj. Besa Kuçi

Z. Dardan Berisha

Z. Armend Krasniqi

Z. Labinot Halitjaha

Znj. Afërdita Mamaj

Znj. Merita Basha

Znj. Antigona Zyba

Z. Liridon Fandaj

Z. Qëndrim Elshani

Znj. Laureta Tafaj

Znj. Jehona Rrafshi

Lumi

Të pranishëm tjerë:

Kryetari i Komunës

Media dhe qytetarë

OSCE, LMT, KDI

Znj.Habibe Bytyqi

Z.Xheladin Sadikaj

Takimin e kryesoi Kryesuesi i Kuvendit z.Bexhet Kuçi,i cili i njoftoi me rendin e ditës.

REND DITE

1. Dhënia e deklaratës së betimit e anëtares së zëvendësuar;
- 2.Miratimi i procesverbalit nga mbledhja e kaluar;
3. Shqyrtimi i projekt-vendimit për shfuqizimin e vendimit 01-Nr-016-68362;
- 4.Shqyrtimi i projekt-vendimit për themelimin e komiteteve të përhershme;
- 5.Shqyrtimi i projekt-vendimit për emërimin dhe plotësimin e Komitetit për Politikë dhe Financa me anëtarë;
- 6.Shqyrtimi i projekt-vendimit për emërimin dhe plotësimin e Komitetit për Komunitete me anëtarë;

Kryesuesi - e hedh në votom rendin e ditës.

Unanimisht Miratohet

Pika 1.Dhënia e deklaratës së betimit e anëtares së zëvendësuar;

Kryesuesi - fton Dafina Kolgecin që ta jap deklaratën e betimit.
Dafina Kolgeci jep deklaratën e betimit.

Pika 2.Miratimi i procesverbalit nga mbledhja e kaluar;

Urim Suka - i kemi vërejt disa lëshime të vogla në procesverbal dhe është mirë që praktika të tilla me mujt mos me u përsërit herën tjetër.Ajo çka ndodh në seancë me mujt me reflektu edhe në procesverbal për faktin që te prezantimi i kandidatëve për Kryesues thuhet vetëm që janë prezantu dhe nuk shkruhen fjalët çka kemi thënë për atë pjesë dhe te fjala e Kryesuesit vetëm thuhet që Kryesuesi e mbajti fjalën dhe nuk reflektojnë fjalët që i ka thënë.

Kryesuesi - e hedh në votim pikën 1 me vërejtjet që u thanë.

Unanimisht Miratohet pika 2

Pika 3. Shqyrtimi i projekt-vendimit për shfuqizimin e vendimit 01-Nr-016-68362;

Kryesuesi - e elaboron pikën dhe hap debatin.

Urim Suka - nga mbledhjet e kaluara që i kemi pas këto vërejtje kanë qenë gati në secilën mbledhje,jemi detyru me shfuqizu nga një vendim.Nuk është një lëshim por është një praktikë që e keni ndjek por ajo që më shqetëson më së shumti është që ne si anëtarë të Kuvendit nuk e kemi para vetes arsyetimin që e ka dhënë Ministria dhe se ne nuk i dimë arsyet se pse sot po e bëjmë këtë shfuqizim. Kërkoj sqarim nga ju se pse nuk e kemi marrë një material të tillë,që ne sot me ditë çka me vendos?Ju lus që në praktikën e ardhshme,çdo gjë që asambleistat duhet me pas,le ta kenë para vetës në mënyrë që të mos bien në lajthitje për me marrë vendime jo të drejta.Nëse keni ndonjë kopje tash me na ofru që ta kemi të qartë për mënyrën pse do të votojmë.

Kryesuesi - pajtohem me ty që është dashtë të ju përcjellim shkresën e Ministrisë por arsyen se pse nuk ka ardhë,është përgjegjësi e zyrës së Kuvendit. Në të ardhmen besoj që do t'ju përcjellim çdo shkresë që na vjen nga Ministria.

Liridon Fandaj - te pjesa e vendimit pajtohem me Urimin që nuk na është sjell shkresa e vendimit dhe nuk e dimë arsyen pse është shfuqizu por ajo që më intereson mua është,që nëse ne po e

shfuqizojmë, si kanë me u ngarku? A do të ngarkohen me normën e vjetër qytetarët apo duhet me prit vendimin e pastaj me u ngarku me tatim për këtë pjesë ?

Kryesuesi - realisht kanë me u ngarku me normën e vjetër sepse ashtu e kanë parapa.

Avni Bytyqi - zyrtari ligjor jep sqarime dhe thotë: siq e përmendi Kryesuesi ky vendim është kthyer në rishqyrtim si pasojë që Drejtoria e e Financave në vitin 2024 është dasht me marrë një vendim të tillë, që të planifikoj shkallën progresive të rritjes së tatimit në pronë për vitin 2026, ndërsa shkalla e tatimit në pronë për vitin 2025 ka qenë tranzistore dhe me ligjin për buxhetin pikërisht për këtë çështje e ka kthyer ministria dhe jo që ka pas ndonjë shkelje ligjore. Ministria me ligjin për buxhetin e ka planifikuar tatimin në pronë për të gjitha komunat. Pra, ato komuna të cilat nuk kanë nxjerr vendim për caktimin e normës tatimore sipas ligjit për tatimin në pronë që është e parapa sipas shkallës progresive, e ka parapa që në vitin 2026 të aplikohet shkalla progresive sipas ligjit pa e marrë miratimin e komunave dhe për këtë arsye e ka kthyer në rishqyrtim. Komuna ka për obligim që këtë vit ta merr një vendim të tillë nëse don, të bën vlerën e tatimit në pronë për vitin 2027.

Flamur Bytyqi - ndoshta jam njëri prej asambleistave të vetëm që e kam kundërshtuar këtë vendim duke pas parasysh që ka qenë një vendim i pa menduar mirë dhe i pa konsultuar dhe unë shpreh një keqardhje që gjithë kolegët kanë ra në lajthitje duke mendu që po i ndihmojmë qytetarëve. Kjo është përdor pikërisht në kohë fushate dhe shpreh një keqardhje që këso vendime mos me na ardhë në kohë fushate dhe me u bo në konsultim me neve si anëtar të Kuvendit por edhe me ekspertë.

Kryesuesi - e hedhë në votim pikën 3.

17 për, 8 apstenime, Miratohet pika 3

Pika 4. Shqyrtimi i projekt-vendimit për themelimin e komiteteve të përhershme;

Kryesuesi - e elaboron pikën dhe hap debatin. Pasi nuk ka debat e hedh në votim pikën 4.

Unanimisht Miratohet pika 4

Pika 5. Shqyrtimi i projekt-vendimit për emërimin dhe plotësimin e Komitetit për Politikë dhe Financa me anëtarë;

Kryesuesi - në bazë të ulëseve të fituara nga subjektet politike në Kuvendin Komunal në Suharekë, subjektit politik AAK i takojnë 3 ulëse ose anëtarë, LDK-së i takojnë 2 ulëse ose anëtarë, PDK-së i takon 1 ulëse ose anëtar dhe LVV-së 1 ulëse ose anëtar. Mandati i KPF-së zgjat aq sa zgjat mandati i rregullt ligjor i kuvendit të komunës së Suharekës. Kërkoj nga subjektet politike të japin propozimet e tyre dhe të reflektojnë në bazë të ligjit për barazi gjinore.

Aziz Bytyqi - në emër të grupit të AAK-së propozoj Mimoza Bajraktari dhe Enver Shabani.

Nexhat Ramadani - në emër të grupit të LDK-së propozojmë Flamur Bytyçin dhe Sanie Kuçi Rexhepaj.

Armend Krasniqi - grupi parlamentar i PDK-së propozon Dardan Berishën për këtë komitet.

Liridon Fandaj - grupi i LVV-së propozon Laureta Tafaj.

Kryesuesi - unë si kryesues shkoj me automatizëm andaj e hedh në votim pikën 5 me këtë propozim: Bexhet Kuçi, Mimoza Bajraktari, Enver Shabani, Flamur Bytyçi, Sanie Kuçi Rexhepaj, Dardan Berisha dhe Laureta Tafaj.

26 për, 1 apstenim, Miratohet pika 5

Pika 6. Shqyrtimi i projekt-vendimit për emërimin dhe plotësimin e Komitetit për Komunitete me anëtarë;

Kryesuesi - Komiteti për Komunitete do të ketë 7 anëtar, ku 3 anëtar vijnë nga tri subjektet politike të Kuvendit komunal të cilat kanë numër më të madh të ulëseve kurse 4 ulëse janë të rezervuara për minoritete. Edhe ky komision e ka mandatin aq sa kanë anëtarët e Kuvendit mandat dhe gjithëashtu edhe këtu duhet të respektohet ligji për barazi gjinore. Kërkoj propozimet nga subjektet politike AAK, LDK dhe PDK.

Mimoza Bajraktari - grupi i AAK-së propozon Aziz Bytyqin.

Nexhat Ramadani - grupi i LDK-së propozon Urim Sukën për këtë komitet.

Dardan Berisha - fillimisht Dafina Kolgecit i urojmë suksese në rrugëtimin e saj. Grupi i PDK-së propozon Merita Bashën për këtë komision.

Kryesuesi - nga komuniteti ashkali është propozuar Përparim Shehu dhe Amara Sofra. Nga komuniteti rom është propozuar Zek Berisha dhe nga komuniteti egjiptas është propozuar Nazim Shabanaj.

Urim Suka - përzgjedhja e anëtarëve të komuniteteve mbi çfarë baze është bërë? Kërkoj sqarime.

Kryesuesi - këto propozime kanë ardhë nga vet këto komunitete. Kemi një problem sepse nuk e kemi kuotën e gjinisë femërore.

Dardan Berisha - kryetari i PDAK-së qenka këtu dhe nëse mundet me na ndihmu në këtë drejtim.

Liridon Fandaj - është çudi sepse krejt fushatën si parti që i keni fitu zgjedhjet keni thënë që jeni për barazi gjinore e tash për një komision pykoi kështu.

Nexhat Ramadani - ju takon juve dhe mos e zgjatni më shumë.

Kryesuesi - 10 minuta pauzë për të gjetur një zgjidhje.

Kryesuesi - zgjidhja është bërë për komisionin komiteti për komunitete ku nga komuniteti ashkali hiqet Përparim Shehu dhe vjen Shkëndije Shabanaj. E hedh në votim pikën 6 me këto propozime: Aziz Bytyqi, Urim Suka, Merita Basha, Shkëndije Shabanaj, Amara Sofra, Zek Berisha dhe Nazim Shabanaj.

26 për, 1 apstenim, Miratohet pika 6

Takimi përfundoi: 10:40

Procesmbajtësja: Dafina Haziraj



Kryesuesi i Kuvendit

Mr. ec Bexhet Kuçi

